



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAVAJË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Datë \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_ / 2022

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: **"BUNA" shpk**

Adresa: Durres, Lagjja 14, "Bajram Tusha", Shkozet

Procedura e prokurimit/lotit: **E Hapur**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-23291-03-28-2022

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Mobilimi i shkollës së mesme profesionale Charles Telford Erickson

Fondi limit: **10,692,500** (dhjetë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e pesëqind) **lekë** pa tvsh

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 45 ditë

Publikimet e mëparshme (nëse është rast): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Muca shpk; me NIPT K01421002H;

Vlera nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

2. Bajro Bros shpk; me NIPT M11313029O;

Vlera nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

3. Klame shpk; me NIPT K21518003F;

Vlera 8,642,230 (tetë milion e gjashtëqind e dyzet e dy mijë e gjashtëqind e tridhjetë) lekë pa tvsh

4. Buna shpk; me NIPT J61826501C;

Vlera 10,460,000 (dhjetë milion e katërqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë pa tvsh

5. "M. LEZHA" shpk; me NIPT J76504013C;

Vlera 10,590,000 (dhjetë milion e pesëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa tvsh

6. Erald shpk; me NIPT J74517205P;

Vlera 10,630,000 (dhjetë milion e gjashtërqind e tridhjetë mijë) lekë pa tvsh

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Muca shpk, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument në SPE.
2. Bajro Bros shpk, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument në SPE.
3. Klame shpk për mangësitë si më poshtë:

- i. Nga shqyrtimi i të dhënave të shtojcës nr.8 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit operatori ekonomik Klame shpk ka deklaruar në pikën "B", se do të mbështetet mbi kapacitetet e operatorit ekonomik Metlind-AL shpk, konkretisht me kapacitete "Numri i punonjesve me 5 punonjes nga subjekti mbështetes te cilet do te kryejne sherbim transporti dhe montimi" dhe "Automjete transporti".

Në zbatim të nenit 90", pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 në të cilin thuhet "Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës; t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme; t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së." dhe detyrimit të përcaktuar në paragrafin e parafundit të shtojcës nr.8 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit ku citohet se "Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetes." Nga operatori ekonomik Metlind-AL shpk nuk është paraqitur Formular i veçantë i Vetëdeklarimit për të përmbushjen e kërkesave ligjore dhe nuk është paraqitur dokumentacion provues mbi kapacitetet mbështetëse.

- ii. Në pikën 2.3.3 është kërkuar se për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit për mesatarisht 20 (njëzet) punonjës.

Nga shqyrtimi i të dhënave të shtojcës nr.8 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit operatori ekonomik Klame shpk ka deklaruar se ka mesatarisht 17 (shtatëmbëdhjetë) punonjës. Nisur nga deklarata e tij, numri i punëtorëve që operatori ekonomik ka, nuk plotëson kërkesën e pikës 2.3.3 të Autoritetit Kontraktor për fuqinë mesatare punëtore.

Numri I punëtorëve I deklaruar për operatorin ekonomik mbështetës Metlind-AL shpk nuk merret në konsideratë duke qenë se nuk përmbush kërkesat ligjore sic argumentohet në pikën "j".

- iii. Në pikën 2.3.4 është kërkuar se për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për 2 (dy) mjete transporti me kapacitet mbajtës ≥1.5 ton.

Nga shqyrtimi i të dhënave të shtojcës nr.8 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit operatori ekonomik Klame shpk ka deklaruar se ka në pronësi mjet transporti kamioncine me kapacitet mbajtes deri ne 3.5 ton me targe TR0123M, në pronësi mjet transporti kamioncine deri ne 3.5 ton me targe AA387HD dhe me qira mjet transporti ATP me kapacitet mbajtes deri ne 3.5 ton me targe AA841SB. Gjithashtu operatori ekonomik Klame shpk ka paraqitur edhe dokumentacionin për secilin mjet. Duhet të theksojmë formulimi i deklarimit për kapacitetin e mjeteve është devijuar nga kërkesa e Autoritetit Kontraktor. Është kërkuar që mjetet të jenë

me kapacitet mbajtës  $\geq 1.5$  ton dhe jo me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton. Me gjithatë nga shqyrtimi i dokumentacionit për secilin mjet dhe krahasimi me të dhënat e vetëdeklaruar konstatohet se:

- mjeti me targa AA387HD, nga të dhënat e lejes së qarkullimit konstatohet se masa maksimale e autorizuar e mjetit është 2950 kg dhe masa e mjetit bosh është 2030 kg. Peshë mbajtëse 920 kg.
- mjeti me targa TR0123M, nga të dhënat e lejes së qarkullimit konstatohet se masa maksimale e autorizuar e mjetit është 1700 kg dhe masa e mjetit bosh është 1035 kg. Peshë mbajtëse rreth 665 kg.
- mjeti me targa AA841SB, i deklaruar me qira. Për këtë mjet nuk ka kontratë qiraje. Mjeti është në pronësi të Metlind-AL shpk, i cili është deklaruar nga operatori ekonomik Klame shpk si operator mbeshtetes. Pavarësisht faktit se nuk plotëson kapacitetin mbajtës ky mjet nuk mund të merret parasysh pasi nuk është paraqitur as kontrata e qerasë nëse është me qera dhe as formulari i vetëdeklarimit nga operatori ekonomik mbeshtetes sic përcaktohet në pikën "i".

Nga sa më sipër, operatori ekonomik Klame shpk nuk plotëson kërkesat e pikës 2.3.4 për disponibilitetin e mjeteve të nevojshme për realizimin e objektit të kontratës.

- iv. Në pikën 2.3.7 është kërkuar se për të provuar për të vërtetuar se mallrat, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit. Operatori ekonomik Klame shpk nuk ka paraqitur certifikatën OHSAS 45001(Standard për menaxhimin e rreziqeve rreth shëndetit dhe sigurimit në punë)/ekuivalente dhe e vlefshme.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë "**BUNA**" shpk me adresë Durrës, Lagja 14, "Bajram Tusha", Shkozë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 10,460,000 (dhjetë milion e katërqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë pa tvsh është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".

Kryetari

**Redjan KRALI**